



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Rev.nr.413/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Beshir Islami dhe Nenad Laziq, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses Sh. K. nga Gj., të cilin e përfaqëson avokati Jeton Ibrahimimi nga Gj., kundër të paditurit I. M. nga Gj., të cilin e përfaqëson me autorizim avokati Halit Azemi nga Gj., për shkak të kompensimit të dëmit jo material, duke vendosur sipas revizionit të paditurit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.7308/2021 dt.10.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me 27.09.2024, mori këtë,

### A K T V E N D I M

HEDHET si i palejuar revizioni i të paditurit I. M. nga Gj., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.7308/21 datë 10.07.2024.

### A r s y e t i m i

Me pjesën e I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.735/18 dt.18.06.2021, aprovohet pjesërisht kërkesëpadia e paditëses, detyrohet i padituri, që paditëses në emër të kompensimit të dëmit jo material, si pasojë e sulmit fizik më dt.14.04.2018, edhe atë për paditësen, për dëmin jo material, për dhimbje fizike dhe frikë, ti paguajë shumën prej 1300-euro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga marrja e aktgjykimit e deri në pagesën definitive. Me pjesën e II të dispozitivit refuzohet si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses, e kërkuar më shumë se shuma e gjykuar. Me pjesën e III të dispozitivit, obligohet i padituri, që paditëses, t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 400-euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Me pjesën e I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.7308/21 të dt.10.07.2024 është aprovuar pjesërisht si e bazuar ankesa e paditëses, dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, i lartë cekur, ndryshohet, ashtu që: aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses, detyrohet i padituri, që paditëses në emër të kompensimit të dëmit jo material të ia paguajë paditëses dhe atë: për dhimbje fizike 1,200.00 euro, për frikë 900-euro dhe për dhimbje shpirtërore shumën prej 800-euro, krejt shumën prej 2,900.00 euro, me kamatë prej

8% nga dt.18.06.2021 deri në pagesën përfundimtare dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 400-euro. Me pjesën e II të dispozitivit, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses nga shumat e kërkuara e deri në shumat e gjetuara, refuzohet si e pa bazuar. Me pjesën e III të dispozitivit, refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurit e paraqitur kundër aktgjyqimit të sipër përmendur të gjykatës së shkallës së parë.

Kundër aktgjyqimit të gjykatës së shkallës së dytë i padituri ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që, të aprovohet revizioni, të prishet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit dhe ai i Gjykatës Themelore në Gjilan, të sipër përmendur, dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjyqimit të goditur dhe të lejueshmërisë së paraqitjes së revizionit, si dhe shkresave të lëndës, sipas nenit 218 par.2 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjeti se:

Revizioni i të paditurit është i palejuar.

Me dispozitën e nenit 211.2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore parashihet se "Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po qe se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjyqimit nuk i kalon 3.000-euro". Sipas kësaj dispozite ligjore rrjedh se, në rastin konkret, e duke qenë se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjyqimit është 2,900.00 euro, d.m.th. nuk kalon mbi 3.000-euro, revizioni nuk është i lejuar.

Pasi që gjykata e instancës më të ulët nuk ka vepruar në pajtim me nenin 218.1 dhe 2 pika d) të LPK, që të hedh revizionin si të palejuar, Gjykata Supreme e Kosovës, me zbatimin e nenit 221 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u dashtë që të njëjtin ta hedh si të palejuar.

Në mbështetje të dispozitës së nenit 221 lidhur me nenin 218 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË**

Rev.nr.413/2024 datë 27.09. 2024

Kryetari kolegjit

Mr.Sc.Muhamet Rexha